



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201078/27

Tiranë ____/____/2025

Lënda: *Rekomandim për të garantuar respektimin e të drejtës për përfitimin nga rindërtimi i banesës së dëmtuar prej fatkeqësisë natyrore, të z.A. K.*

Drejtuar: BASHKISË TIRANË

Tiranë

**AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
DREJTORISË VENDORE TIRANË VERI**

Tiranë

Për dijeni: Z. A. K.

Tiranë

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, në mbrojtje të të drejtave, lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe interesave të tyre të ligjshme, ka marrë në administrim ankesën drejtuar Avokatit të Popullit, nga shtetasi A. K., në lidhje me përfitimin nga programi i rindërtimit për tërmetin e nëntorit të vitit 2019, për ndërtesën e banimit me adresë Njësia Adm. Nr. 3, në Tiranë.

Ankuesi ka shprehur se nëpërmjet shkresës suaj (të Bashkisë Tiranë) datë 01.03.2021 "Kthim përgjigje" shpreheni se nëpërmjet shkresës më datë 23.12.2020 pranë Bashkisë Tiranë keni përcjellë ankesën për rishikim të dosjes së ankuesit, si rezultat i skualifikimit nga programet e rindërtimit, me arsyetimin se ankuesi disponon dy prona në pronësinë e tij dhe mbi normat e strehimit, dhe ndër të tjera shpreheni se ankuesi është dhe tej afatit të ankimit. Në vijim të problematikës sa më sipër, z. A. K. ka ushtruar edhe dy herë të drejtën e ankimit (datë 13.09.2021 dhe 09.05.2022), gjë që nuk është marrë në konsideratë nga ana juaj, pasi është vlerësuar në kundërshtim me

pikën 4, të nenit 128 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” ku parashikohet se pala nuk ka të drejtë të ushtrojë për së dyti mjetet ligjore administrative për të njëjtën çështje. Lidhur me këtë fakt, ankuesi i ka kërkuar informacion DVASHK Tiranë. Me shkresën më datë 13.07.2021, kjo e fundit ka kthyer përgjigje ankuesit se në emër të z.Y. K. , nuk rezulton e regjistruar asnjë pasuri. Ankuesi e ka ankimuar vendimin e Bashkisë Tiranë duke ju vënë në dispozicion informacionin nga DVASHK, por përsëri është refuzuar me pretendimin se pala nuk ka të drejtë të ushtrojë për së dyti të njëjtën ankesë. Gjendur para kësaj situatë, ankuesi iu drejtua institucionit tonë për hetimin administrativ të çështjes dhe zgjidhjen e saj.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike shqiptare, në përputhje me nenin 2 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ka konstatuar se rasti plotëson kushtet për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore dhe ka filluar procedurën e shqyrtimit të çështjes duke ndërmarrë një proces hetimi administrativ.

Për këtë i kemi kërkuar fillimisht Bashkisë Tiranë me shkresën nr. K3/A44-2 prot., datë 16.09.2022 të na përcillen informacione nëse qëndron pretendimi i ankuesit, arsyen dhe shkakun ligjor të mostrajtitimit të këtij rasti, si dhe gjithë dokumentacionin që disponon për këtë rast dhe që mbështet qëndrimin tuaj, veçanërisht konfirmimin e DVASHK-së Tiranë, lidhur me disponimin e dy banesave nga z.Y. K. dhe familja e tij. Në vijim me shkresën tuaj më datë 27.9.2022 “Kthim përgjigje” na bëni me dije se sipas verifikimeve tuaja nuk është depozituar asnjë praktikë në emër të z. A. K..

Me shkresën tonë nr. K3/A44-6 prot., datë 28.03.2023, pasi administronim të gjithë dokumentacionin provues nga ankuesi, ju kemi kërkuar shpjegime për rastin duke ju vënë në dispozicion një kopje të këtij dokumentacioni. Me shkresën tuaj më datë 3.5.2023 “Kthim përgjigje” na informoni se z. A. K. është skualifikuar nga Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Subjekteve Përfituese nga Programet e Procesit të Rindërtimit, në raportin përmbledhës të datës 26.10.2020, miratuar me Vendimin nr. 146, datë 30.10.2020, të Këshillit Bashkiak, me arsyetimin se një nga anëtarët e familjes (vëllai), rezultoi të ketë dy prona, referuar pikës 13, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”.¹

¹ Sipas kësaj dispozite parashikohet: “Struktura përgjegjëse u njofton aplikantëve jofitues edhe arsyet e kësaj vendimmarrjeje, si dhe vendimit për përfitim nga një program tjetër i procesit të rindërtimit. Aplikantët jofitues mund të paraqesin ankesat e tyre pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, brenda 5 ditëve nga njoftimi”.

Në vijim, me shkresën tonë nr. K3/A44-9 prot., datë 24.05.2023 *“Kërkesë e përsëritur për shpjegime”* drejtuar Bashkisë Tiranë dhe Komisionit të Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Subjekteve Përfituese nga Programet e Procesit të Rindërtimit pranë Bashkisë suaj, kemi rikërkuar informacionin dhe dokumentacionin e plotë mbi praktikën e ndjekur ndaj këtij ankuesi dhe ku mbështetet dhe vendimi juaj për mospërfshirjen e tij si subjekt përfitues.

Me shkresën tuaj më datë 20.6.2023 me lëndë *“Kthim përgjigje”* na keni vënë në dispozicion dokumentacionin e rastit mbi problematikat e ngritura nga ana e kërkuarit, dhe që mbështesni se në momentin kur është kryer aplikimi, z. Y. K. rezulton se gjatë shqyrtimit të praktikës si dhe nga verifikimet e Njesisë Administrative nr. 3, të ketë 2 prona në emër të tij, anëtar në certifikatën familjare në momentin e aplikimit, dokument që gjendet në praktikën e aplikimit. Ndër të tjera, sqaroni se, Komisioni i Posaçëm, shqyrtoi dhe vlerësoi aplikimet me nivel dëmi DS1, DS2, DS3, DS4 dhe DS5 sipas dokumentacionit të paraqitur në fazën e aplikimit, të përcjella nga drejtoritë përgjegjëse, të cilat koordinojnë me Njësine Administrative dhe lagjet e Bashkisë Tiranë, dhe në vijim nëpërmjet raporteve përmbledhëse të miratuara nga Kryetari vijoi më tej me propozimin për miratimin nga Këshilli Bashkiak, si organ vendimmarrës. Për sa i përket rastit në fjalë, na informoni se z. A. K. ka aplikuar pranë Njesisë Administrative nr.3, me përbërje familjare prej 5 anëtarësh dhe me datë aplikimi 23.02.2020.

Për sa më lart, me shkresën tonë nr. K3/A44-11 prot., datë 17.07.2023 *“Kërkesë e përsëritur për shpjegime”* i jemi drejtuar Komisionit të Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Subjekteve Përfituese nga Programet e Procesit të Rindërtimit pranë Bashkisë suaj dhe Njesisë Administrative nr. 3 në Tiranë duke kërkuar informacion të detajuar dhe shterues në lidhje me: *“Rastin e familjes A. K., i cili ka nisur aplikimin pranë institucionit tuaj, si dhe të na vini në dispozicion gjithë dokumentacionin që është administruar nga ana juaj për këtë rast, veçanërisht raportet e hartuara nga ana juaj si dhe konfirmimin lidhur me disponimin e dy banesave nga z.Y. K.”*. Me shkresën më datë 31.07.2023, *“Kthim përgjigje”* Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Subjekteve Përfituese nga Programet e Procesit të Rindërtimit pranë Bashkisë suaj, ndër të tjera, na ka vënë në dispozicion edhe shkresën e datës 26.10.2020 *“Raport përmbledhës për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për nënprogramin e grantit të rikonstruksionit pjesë e programit të grantit të rindërtimit”*, ku rezulton se z. A. K. me nivel dëmi DS3 skualifikohet me arsyen se ka pronë të dytë mbi normat e strehimit.

Gjendur para kësaj sate, i jemi drejtuar D.V.A.SH.K. në Tiranë me shkresat nr. K3/A44-13 prot., datë 25.08.2023 *“Kërkesë për shpjegime”* dhe nr.K3/A44-15 prot., datë 05.10.2023 *“Kërkesë e përsëritur për shpjegime”* ku kemi kërkuar informacion mbi gjendjen pasurore të z. Y. K. për periudhën e cila përkon me kohën e aplikimit për

të përfituar nga procesi i rindërtimit, duke na vënë në dispozicion të gjithë informacionin e duhur.

Për sa më lart, D.V.A.SH.K. me shkresën më datë 24.10.2023 “Kthim përgjigje” na bën me dije se “...nga verifikimi i kryer në sistemin multifunksional të pasurive të paluajtshme u konstatua se z. Y. K. nuk rezulton të ketë pasuri të paluajtshme të regjistruara në zonat kadastrale në juridiksionin e kësaj Drejtorie. Gjatë verifikimit **është konstatuar se kemi të bëjmë me një gabim material në hedhjen e të dhënave në sistem**, pasi rezulton se shtetasi Y. R. K. rezulton me nr. personal identifikimi *** dhe ka pasur pasuri të rregjistruar me nr.***, Z.K. 8310 lloji “Apartament”. Ndërkohë që, nga verifikimi i kryer në sistemin multifunksional të pasurive të paluajtshme u konstatua se z.Y. K. me nr. personal identifikimi *** **nuk rezulton të ketë pasuri të paluajtshme të rregjistruara në zonat kadastrale në juridiksionin e kësaj Drejtorie.**”.

Ndodhur para këtij fakti, ju jemi drejtuar përsëri me shkresat nr. K3/A44-19 prot., datë 19.12.2023 “Kërkesë për shpjegime” dhe nr. K3/A44-20 prot., datë 15.02.2024 “Kërkesë e përsëritur për shpjegime”, dhe Komisionit të Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Subjekteve Përfituese nga Programet e Procesit të Rindërtimit pranë Njësisë Administrative nr. 3 në Tiranë, për procedurën e ndjekur nga ana juaj në lidhje me marrjen e informacionit nga organet përkatëse për gjendjen pasurore të z. Y. K. dhe më konkretisht pas ankimit të z. A. K. për vendimmarrjen tuaj çfarë hapash janë ndjekur që kanë sjellë në skualifikimin e këtij shtetasi nga grantet e rindërtimit. Kemi kërkuar të na vihet në dispozicion dokumentacioni që është administruar nga ana juaj për këtë procedurë. Gjithashtu, duke u ndodhur para këtij gabimi material nga ana e institucioneve përgjegjëse, cila është procedura e ndjekur nga ana juaj për vënien në vend të kësaj padrejtësie që i është shkaktuar këtij shtetasi. Pra, kemi kërkuar të na informoni se si do vijoni për zgjidhjen e kësaj problematike në mënyrë që t’i jepet fund zvarritjes pa të drejtë për mos kualifikimin e shtetasit A. K. nga fondet e rindërtimit.

Në lidhje me kërkesat tona, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Subjekteve Përfituese nga Programet e Procesit të Rindërtimit pranë institucionit tuaj me shkresën më datë 15.2.2024 “Kërkesë për bashkëpunim” i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit (për dijeni edhe institucionin tonë) lidhur me procedurën që mund të ndiqet kur pretendohet një gabim material nga ana e institucionit për qytetarin A. K.. Në mungesë të përgjigjes i jemi drejtuar me shkresën tonë nr. K3/A44-24 prot., datë 19.03.2024 “Kërkesë e përsëritur për shpjegime” në vijim dhe të shkresave të sipërcituara të Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit dhe Komisionit të Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Subjekteve Përfituese nga Programet e Procesit të Rindërtimit.

Në përfundim me shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit më datë 7.5.2024 “Kthim përgjigje” jemi informuar ndër të tjera... “shtetasi

i sipërcituar ka ushtruar dhe të drejtën e ankimit administrativ pranë strukturës ankimore të Bashkisë Tiranë. Për sa më sipër, bazuar në nenin 129, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” sipas të cilit parashikohet se shtetimi i ankimit administrativ, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështje administrative, z. A. K., për zgjidhjen e kësaj çështjeje mund ti drejtohet gjykatës kompetente.”.

Në vijim të korrespondencës me ankuesin dhe Bashkinë Tiranë rezulton të jenë kryer këto veprime:

- Bazuar në legjislacionin në fuqi z. A. K. ka aplikuar pranë Njesisë Administrative nr.3, me nr. Identifikues i aplikimit dhe datë aplikimi 23/02/2020, për t’u trajtuar nga programi i granteve të rindërtimit me përbërje familjare prej 5 anëtarësh z. I. K. , z. Y. K. , z. A. K. , znj. L. K. si dhe znj. E. K. , aplikim i cili është shoqëruar me vërtetimin që konfirmon regjistrimin e aplikimit, objektin, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura.
- Është përgatitur raporti përmbledhës për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për nënprogramin e grantit të rikonstruksionit pjesë e programit të grantit të rindërtimit me më datë 26.10.2020, të Komisionit të Posaçëm të Shqyrtimit dhe Vlerësimit të Aplikimeve për të përfituar nga Programet e Procesit të Rindërtimit në Bashkinë Tiranë për skualifikimin e shtetasit.
- Është bërë ankim nga z. A. K. për rishikimin e dosjes së tij, pranë Bashkisë Tiranë, më datë 23.12.2020.
- Më datë 01.03.2021, “Kthim përgjigje” e Bashkisë Tiranë drejtuar shtetasit A.K. , i është bërë me dije se nga verifikimet e bëra nga Njësia Administrative nr. 3, rezulton se ka dy prona në emër të vëllait të tij z. Y. K. duke sjellë për pasojë mosmarrjen në konsideratë të kërkesës së tij bazuar legjislacionit në fuqi.
- Më datë 13.07.2021, DVASHK-ja Tiranë i ka lëshuar vërtetim ankuesit për gjendjen pasurore të vëllait të tij z.Y. K. .
- Më datë 13.09.2021, dhe më datë 09.05.2022 ka kryer përsëri ankim shtetasi A.K. pranë Bashkisë Tiranë, për të kundërshtuar vendimin e skualifikimit të aplikimit nga proceset e rindërtimit.
- Më datë 31.12.2021 dhe më datë 24.05.2022 “Kthim përgjigje” të Bashkisë Tiranë, respektivisht, drejtuar shtetasit A. K. është bërë me dije se pala nuk mund të ushtrojë për së dyti mjetet ligjore administrative për të njëjtën çështje.
- Më datë 24.10.2023 DVASHK-ja ka pranuar që është bërë një gabim material në hedhjen e të dhënave në sistem.
- Më datë 7.5.2024 “Kthim përgjigje” të Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit të Bashkisë Tiranë është lënë zgjidhja e çështjes në kompetencë të gjyqësorit, pa i dhënë mundësinë ankuesit të mund të ndreqë në mënyrë administrative, gabimin e pranuar nga DVASHK.

Procedura e përfitimit nga programi i rindërtimit është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr.5, datë 06.01.2020, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i cili parashikon në pikën 13 se, “Njësitë e vetëqeverisjes vendore regjistrojnë aplikimet në një sistem elektronik, i cili jep mundësinë e përpunimit të të dhënave, si më poshtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e aplikimit; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për të përfituar nga programi i grantit të rindërtimit dhe tipi i projektit model të zgjedhur ose projektin e kryer vetë nga kërkuuesi/aplikanti; d) adresën e kërkuarit; dh) Përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) aktekspertizën e thelluar, të lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose çdo person, fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa e shpallur si e pabanueshme; ë) çdolloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar; f) të dhënat e llogarisë bankare të kërkuarit pranë një banke të nivelit të dytë.”.

Ndërsa në pikën 19 të këtij vendimi parashikohet se: “Aplikantëve jofitues, struktura përgjegjëse u njofton edhe arsyet e kësaj vendimmarrjeje si dhe të vendimit për përfitim nga një program tjetër i procesit të rindërtimit, nëse kjo është e mundur. Aplikantët jofitues mund të paraqesin ankesat e tyre pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose pranë autoritetit përgjegjës, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.”

Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, i Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97, datë 18.12.2019, në pikën 1, të nenit 5 “Subjektet përfituese” të këtij akti parashikohet se “1. Subjekte përfituese janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.”

Për sa më lart rezulton se, edhe pse është konstatuar nga ana e DVASHK-së se ka pasur një gabim material i cili vjen nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, kjo nuk ka sjellë për pasojë mundësinë e rishikimit të zgjidhjes dhe rishikimit të këtij rasti nga ana juaj. Këtu kemi parasysh edhe përmbajtjen e legjislacionit në fuqi i cili parashikon shprehimisht mënyrën dhe rastet se kur qytetarët përfitojnë nga rastet e fatkeqësive natyrore.

Kodi i Procedurës Administrative (KPrA) parashikon në nenin 112 “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, i cili parashikon se “1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.”

Aktet me gabime materiale nuk janë të paligjshme (neni 112 KPrA) dhe për këtë arsye ato nuk çojnë në ngritjen e padive gjyqësore.² Vetë ankuesi e ka ankimuar vendimin për mospërfitimin e tij nga programet e rindërtimit pranë Bashkisë, dhe ndërkohë që ankimi i tij është jashtë afateve ligjore dhe se refuzohet për të njëjtën arsye të cilën ka sjellë për pasojë gabimi material.

Duke u ndodhur para kësaj situate, siç kemi cituar më sipër, vetë ankuesi është drejtuar organeve përgjegjëse duke marrë vërtetimin që nuk rezulton asnjë pronë e dytë në emër të vëllait të tij, dhe duke e paraqitur pranë institucionit tuaj. (vërtetuar kjo dhe nga ana jonë).

Për shkak të gabimeve të drejtshkrimit dhe të përllogaritjes dhe gabimeve të tjera të dukshme, dispozita përjashtimore e nenit 112 i lejon organit publik të korrigjojë gabimet e tilla duke “qartësuar” me mjete më pak formale administrative atë që njihet nga versioni i pakorrigjuar i aktit. Në këtë mënyrë, dispozita ndjek qëllimin e garantimit si të parimit të qartësisë ligjore ashtu edhe të efikasitetit të procedurës administrative (neni 18).³ Korrigjimi mund të kryhet kryesisht ose me kërkesë të palëve⁴.

Në vlerësimin tonë, mungesa e veprimit për korrigjimin e gabimit material, i cili është **një fakt tashmë i pranuar zyrtarisht nga vetë ASHK**, përbën një shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe efektivitetit të administratës. Rrjedhimisht, mosveprimi i Bashkisë Tiranë për të trajtuar në mënyrë substanciale këtë kërkesë të qytetarit, pavarësisht kalimit të afatit formal të ankimit, përbën jo vetëm **mosrespektim të nenit 112 të KPrA-së**, por edhe një **mungesë vullneti administrativ për të ndrequr një padrejtësi të dokumentuar dhe të shmangshme**.

Më tej, neni 112 i KPrA-së nuk përmban asnjë kufizim kohor për korrigjimin e gabimeve materiale, pikërisht për të shmangur situata ku qytetarët dëmtohen për shkak të pasaktësive të vetë administratës. Kjo nënkupton se, **detyrimi për të vepruar në këtë rast nuk është fakultativ, por një obligim pozitiv i organit publik** për të përmirësuar një akt të gabuar që prodhon pasoja të padrejta.

² Komentari i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë nga SIGMA, Tiranë, 2018, fq. 516.

³ Po aty fq. 543.

⁴ Po aty, fq. 544.

Rrjedhimisht, është qëndrim i qartë i Institucionit të Avokatit të Popullit se, **kur ekziston një provë dokumentare që përjashton bazën për skualifikim**, sikurse është rasti i vërtetimit të DVASHK-së për mospasjen e pronës, administrata nuk ka asnjë justifikim ligjor për të refuzuar rishikimin e çështjes në rrugë administrative. Përkundrazi, çdo neglizhencë në këtë drejtim është **shkelje e detyrimeve themelore ligjore dhe kushtetuese të administratës ndaj qytetarëve**.

Në vijim, bazuar dhe në nenin 15 “*Parimi i përgjegjësisë*” i KPrA-së, i cili ka për qëllim ndër të tjera të qartësojë se organet publike dhe punonjësit e tyre janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta.

Korrigjimi është kryer dhe ju është vënë në dispozicion si nga ankuesi ashtu edhe nga korrespondenca që kemi pasur midis institucioneve tona. Megjithatë ju sugjeroni se ankuesit i ka ngelur vetëm rruga gjyqësore për zgjidhjen e kësaj problematike.

Duhet theksuar se, Avokati i Popullit është institucion kushtetues, i cili ka rol “*kontrollues*” mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me, zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t’u krijohen shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike, përveç gjykatave.

Legjislatori ka parashikuar si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në trajtimin e problemeve, si dhe mungesën e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë. Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata shtetërore ndërkohë që, të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Megjithatë, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta theksojmë se, detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit, gjatë hetimit administrativ, veçse një detyrim i karakterit administrativ është një detyrim Kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky organ publik.

Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike, sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Në konkluzion të sa u parashtrua dhe arsyetua në këtë rekomandim, vlerësojmë se sjellja e Bashkisë Tiranë përkundrejt ankuesit por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi nuk garanton standardin e nevojshëm për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve.

Për më tepër, është detyrë e organeve administrative që, në përputhje me parimin e përgjegjësisë dhe atë të bashkëpunimit të ndersjelltë ndërinstytucional, të mos i mbyllin rrugën administrative një qytetari të dëmtuar nga gabime të dokumentuara të vetë administratës. Të orientosh qytetarin drejt gjykatës, kur ekziston qartazi mundësia dhe detyrimi ligjor për zgjidhje në rrugë administrative, përbën jo vetëm shmangie nga përgjegjësia institucionale, por edhe një formë e heshtur e mohimit të së drejtës për trajtim të barabartë dhe efikas nga organet publike. Institucioni i Avokatit të Popullit e konsideron këtë qasje të papranueshme dhe në kundërshtim me standardet e së drejtës administrative bashkëkohore, e cila vendos në qendër mbrojtjen efektive të individit dhe korrigjimin me përparësi të padrejtësive të shkaktuara nga vetë shteti.

Në vlerësimin tonë, referuar shkresës së DVASHK-së me datë 24.10.2023, është e qartë se pasaktësia mbi zotërimin e pronave nga z.Y. K. ka ardhur si pasojë e një gabimi material në regjistrat kadastralë. Ky gabim është i pranuar zyrtarisht nga vetë institucioni përgjegjës, dhe si i tillë nuk mund të përbëjë bazë të vlefshme për skualifikimin e z. A. K. nga programi i rindërtimit. Gjithashtu, nga asnjë dokument i administruar gjatë hetimit nuk rezulton që, në momentin e aplikimit fillestar të z. A.K., ekzistonte një pronë në emër të ndonjë anëtarit të familjes që do ta bënte të papërshtatshëm për përfitim, sipas legjislacionit në fuqi. Në këto kushte, konstatohet se vendimi për skualifikim është marrë në mungesë të fakteve të sakta dhe në kundërshtim me të drejtën e qytetarit për përfitim të barabartë nga programi i rindërtimit. Rrjedhimisht, ky konstatim i mëvonshëm – i dalë si pasojë e hetimit administrativ – **ka vlerë shfuqizuese për çdo vendim të marrë në bazë të një pasaktësie faktike**, dhe duhet të çojë në rishqyrtimin e menjëhershëm të rastit, duke marrë në konsideratë të drejtën legjitime të ankuesit për të përfituar nga programi i rindërtimit.

Sa më lart, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për*

vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

R E K O M A N D O J M Ë:

1. Marrjen e masave nga Bashkia Tiranë për rishikimin e praktikës së z. A. K. për të garantuar respektimin e të drejtës së qytetarit për përfitimin nga fondet e rindërtimit për banesën e dëmtuar për shkak të fatkeqësisë natyrore dhe rishqyrtimin e rastit të këtij shtetasi.
2. Marrjen e masave nga DVASHK Tirana Veri për bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për rastin e z. A. K. dhe mospërsëritjen e rasteve të ngjashme në të ardhmen për të evituar gabimet e mundshme në të ardhmen.
3. Marrjen e masave nga Bashkia Tiranë që gjatë ushtrimit të veprimtarisë në drejtim të ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët të jetë më fleksibël, duke dëgjuar/adresuar drejt qytetarët si dhe duke respektuar maksimalisht të drejtat e tyre.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi si dhe masat disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, konform nenit 22, të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “ Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI